



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 47

Datë: 02. 09. 2024 ora: 14:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Ilir Gashi, Arianit Elshani, Alban Krasniqi, Sami Hamiti, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Fazli Stollaj, Qemailj Kurtis, Mufera Shinik.

Burim Ahmetaj, krye shef i SKQZ. Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**
- 2. Procesverbali i mbledhjes së KQZ nr.45 dhe 46/2024**
- 3. Aktivitetet e Sekretariatit**
- 4. Raport i Këshillave të KQZ**

4.1.Këshilli për Buxhet dhe Financa

- Shqyrtimi dhe miratimi i planit të buxhetit për organizimin e punëtorisë në mes të KQZ së Kosoves dhe KQZ së Shqiperisë;

4.2.Këshilli për Operacione Zgjedhore

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Listës së Qendrave Komunale të Numërimit;

2. Shqyrtimi dhe miratimi i agjendës për mbajtjen e punëtorisë për mësimet e nxëna për projektin “Simulimi i procesit zgjedhor”;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i projektit dhe agjendës për takimin mes KQZ së Kosovës dhe KQZ së Shqipërisë;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave për fletëvotime dhe lista votuese për Zgjedhjet 2025;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave për të verbër për Zgjedhjet 2025;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave teknike për transportin e materialit zgjedhor;
7. Shqyrtimi dhe miratim i kërkesës për ngritjen e kapaciteteve të infrastrukturës të IT;

5. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Me hapjen e takimit, kryetari Radoniqi paraqiti agjendën e takimit. Anëtarët e KQZ-së, sugjeruan ndryshimet në përmbajtje të agjendës: **Ibrahim Selmanaj**, tha se propozoj që një “një kërkesë e Zëdhënësit” të përgatitet dhe të vendoset si pikë e rendit të ditës në mbledhjen e radhës të KQZ. **Alban Krasniqi**, tha se në Këshillin për Personel e kemi diskutue dhe në mbledhjen e radhës do t’i dikutojmë, ashtu si edhe ndryshimet në rregullore. **Arianit Elshani**, propozoi që disa pika të rendit të ditës të hiqen nga KOZ: pika 1, pika 4, pika 5 dhe pika 6. **Ilir Gashi**, tha se në mbledhjen e radhës do të vij me disa rekomandime për ndryshim në disa rregullore.

Anëtarët e KQZ-së me 10 vota për, miratohet. Në vazhdim, me 10 vota për u miratua procesverbali nr. 45, dhe me vërejtjet e Fazli Stollaj, Qemailj Kurtis, të Gordana llabanit dhe Alban Krasniqit nuk u votua procesverbali nr, 46.

2. Aktivitetet e Sekretariatit

Burim Ahmetaj, kryeshef i Sekretariatit tha se më 22 gusht pas miratimit të ftesës dhe listës së Subjekteve Politike nga Këshilli për Operacione Zgjedhore, Sekretariati ka dërguar ftesat subjekteve politike për nominim e anëtarëve te KKZ-së. Afati për nominim, është datë 6 shtator 2024. Sekretariati, është në fazën e inspektimit dhe vlerësimit të qendrave të votimit, deri më 10 shtator kur përfundon ky aktivitet.

Më datën 17.08.2024, tha z. Ahmetaj, është bërë kërkesa në ARC për Ekstraktin e Parë, dhe më 20 gusht e kemi ekstraktin me të dhënat e të gjithë shtetasve për të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, të cilët janë të moshës 18 vjeç dhe mbi 18 vjeç, duke përfshirë edhe personat që deri me datën 9 shkurt 2025, mbushin moshën 18 vjeç. Gjithashtu, zbatimi i periudhës së kundërshtimit dhe konfirmimit të LV-së ka filluar me datë 29.08.2024. Nuk kemi pranuar ndonjë kërkesë për kundërshtim të LV, tha z. Ahmetaj.

Në vazhdim, aktivitet tjetër u raportua “Zbatimi i periudhës së regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës”. Z. Ahmetaj, tha se ky aktivitet ka fillua më 29 gusht, dhe do të përfundojë me datën 26 dhjetor. Deri më datën 1 shtator, përmes platformës elektronike Divizioni i Shërbimit Votues ka pranuar 1162 kërkesa për regjistrim, të cilat janë shqyrtuar. Të aprovuara janë 1162 aplikime, ndërsa të refuzuara janë 222 aplikime, tha z. Ahmetaj. Ndër arsyet e refuzimit, janë: dokumente të pakompletuara, kryesisht në shumicën e rasteve nuk është bashkangjitur fotografia me dokumentin në dorë.

Gjithashtu, aktivitet tjetër, është edhe Ndërimi i Qendrave të Votimit i cili aktivitet ka filluar më 29 gusht, dhe do të përfundojë me 26 dhjetor. Janë pranuar gjithsej 85 kërkesa për ndërimin e QV: 69 kërkesa janë aprovuar, ndërsa 14 kërkesa janë refuzuar. Arsyet e refuzimit janë dokumentet e pakompletuara.

Ndër aktivitetet e tjera, z. Ahmetaj përmendi: Aktiviteti i planit të punës së KQZ “Organizimi i takimeve të KQZ-së me Kryetar të Komunave dhe me Kryesuesit e Kuvendeve Komunale” që, është në proces të realizimit. Përgjatë vizitave në komuna, janë nënshkruar katër (4) memorandume të bashkëpunimit mes KQZ dhe Komunave: Obiliq, Hani i Elezit, Prizren dhe Drenas. Jemi në pritje të arritjes edhe të memorandumeve të tjera, shpjegoi z. Ahmetaj.

Lidhur me këtë raport, diskutoi **Arianit Elshani** që tha se lidhur me “Listën Votuese” janë hapur debate se pse ka një numër kaq të madh të votuesve! Ai, ftoi të gjithë qytetarët që ta sfidojnë listën, ti korigojnë emrat, por edhe ene ta intensifikojmë informimin lidhur me këtë çështje.

Alban Krasniqi, diskutoi lidhur me aplikim jashtë vendit, dhe tha se ka një numër të madh refuzimesh. Por, duhet bërë edhe një fushatë më të detajuar që, aspekti informues dhe teknik, të jetë më i qartë sepse, këtu aplikuesit kanë bërë gabime.

3. Raport i Këshillave të KQZ

4. Këshilli për Buxhet dhe Financa

Shqyrtimi dhe miratimi i planit të buxhetit për organizimin e punëtorisë në mes të KQZ së Kosoves dhe KQZ së Shqipërisë:

Gordana Llaban, tha se Këshilli për Buxhet ka mbajtur takim dhe, kemi shqyrtuar buxhetin e takimit në mes të KQZ së Kosovës dhe Shqipërisë. Buxheti i ndarë për këtë takim pune mes dy komisioneve, është: 10, 700 uro. Rekomandojmë për aprovim.

Anëtarët e KQZ, e miratuan këtë rekomandim me 10 vota për.

4. Këshilli për Operacione Zgjedhore

1. Shqyrtimi dhe miratimi i agjendës për mbajtjen e punëtorisë për mësimet e nxëna për projektin “Simulimi i procesit zgjedhor”:

Arianit Elshani tha se KOZ e ka shqyrtuar mbajtjen e një punëtorie për mësimet e nxëna për projektin “Simulimi i procesit zgjedhor” duke qenë se, ne e kemi realizuar këtë projekt gjatë muajit gusht. Gjatë simulimit, ne i kemi të gjeturat dhe të njëjtat, ti diskutojmë dhe të nxjerrim rekomandimet. Punëtorja, përkrahet nga OSBE dhe propozojmë si KOZ të miratohet.

Me 10 vota për, u miratua agjenda për këtë punëtori.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i projektit dhe agjendës për takimin mes KQZ së Kosovës dhe KQZ së Shqipërisë:

Arianit Elshani: E kemi shqyrtuar në KOZ edhe këtë agjendë dhe se, datat kur mbahet takimi mes KQZ të Kosovës dhe KQZ të Shqipërisë, janë: 25, 26 dhe 27 shtator. Ky takim, është treditore ku do të diskutohen disa tematika dhe ne mendojmë se, përfitimet janë reciproke. Është parapa, edhe nënshkrimi i një memorandum. Rekomandojmë të miratohet.

Me 10 vota për, u miratua kjo agjendë.

3. Shqyrtimi dhe miratim i kërkesës për ngritjen e kapaciteteve të infrastrukturës të IT:

Arianit Elshani, tha se e kemi shqyrtuar këtë kërkesë. Është një mbështetje që po vjen nga OSBE, dhe është fjala për një serverum dhe pajisje tjera. Ne, e kemi lënë hapur çështjen, sidomos atë se ku do ta vendosim serverumin. Ne, kemi nevojë shumë dhe rekomandojmë që kjo kërkesë për ngritjen e kapaciteteve të infrastrukturës të IT, ta miratojmë.

Shfrytëzoj rastin edhe njëherë që, ta falënderojë OSBE-në për përkrahjen e vazhdueshme që i jep KQZ-së.

Me 10 vota për, anëtarët e KQZ miratuan këtë kërkesë.

5. Të ndryshme!

